

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“EDStaka” Sh.p.k.

Sot, më date **13.11.2023** ne te nenshkruarit:

- **Ermal Staka** lindur me date 26.06.1989, shtetas Shqiptar, lindur ne Lushnje dhe banues ne Tirane , identifikuar nepermjet kartes se identitetit me nr Id I90626144B , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

- **Herkida Staka** lindur me date 12.07.1990, shtetase Shqiptare, lindudr ne Lushnje dhe banues ne Tirane , identifikuar nepermjet kartes se identitetit me nr Id J05712131U , madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar.

: në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kemi vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar **“EDStaka” Sh.p.k.** (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: **“EDStaka” Sh.p.k**

Neni 2

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën:- Tirane ,Njesia Administrative 5 ,Rruga Sulejman Delvina ,pallati Scutari ,kati perdhe njeria nr 1 ,nr pasurise 4/684-n11 1001

(2)Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: edstaka.2612@gmail.com
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperise.

Neni 3

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Objekti i veprimtarise se shoqerise

Neni 4

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

-Agjensi marketing hapje/mirembajtje web,social media. Agjensi udhetimi. Sherbime te tjera per pagesa elektronike ,etj.



Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000** (njeqinmije) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Z.Ermal Staka**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **49 000** leke që përbën **49%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Znj.Herkida Staka** : Zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **51 000** leke që përbën **51%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë : 100000 leke në para.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund te behet vetem pasi Asamblea e ortakeve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithe ortakët jane te detyruar qe ta repektojne dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asamblese

Neni 7:

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërise
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakeve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve,përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitakit themeltare janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve përjashtimi nga e drejta e votës dhe të tjera modalitete për funksionimin e organit vendimarrës përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë **Ermal Staka** lindur me datë 26.06.1989, shtetas Shqiptar, lindur në Lushnjë dhe banues në Tiranë, identifikuar nepermjet kartës së identitetit me nr Id I90626144B, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i zgjedhur për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorit janë të përcaktuara qartë në statutin e shoqërisë.

Neni 10

Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përrastimisht, viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxirjen e rezulttit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cialt është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për të shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 11

Prishja-riorganizimi i shoqërisë

Modalitetet për prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë janë të përcaktuara në statutin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i Ndryshuar.

Neni 12

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale.

ORTAKET E SHOQERISE "EDStaka"

ERMAL STAKA



HERKIDA STAKA

Herkida Staka

